



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Dt. 30/05/2025
Nr. 3-1082

Komisioni i MASHTI për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të IPAAP, në bazë të dispozitave të nenit 46 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në mbështetje të Udhëzimit administrativ nr. 17/2016 - Kriteret për licencimin dhe rilicencimin e institucioneve arsimore private parauniversitare, të mesme të larta profesionale dhe institucioneve aftësuese profesionale si dhe kërkesës së institucionit “Keka-Med”, rr. “Sadik Rama” në Klinë, me nr. prot.3/1082 të datës 24.03.2025, nxjerr:

VENDIM

1. RILICENCOHET Shkolla Profesionale “Keka-Med”, rr. “Sadik Rama” në Klinë, për ushtrimin e veprimtarisë profesionale për nivelet III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK për programet:
 - 1.1. “Asistent Dentar, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”;
 - 1.2. “Teknik i Farmacisë, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”;
 - 1.3. “Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”.
2. LICENCOHET Shkolla Profesionale “Keka-Med”, rr. “Sadik Rama” në Klinë, për ushtrimin e veprimtarisë profesionale për nivelet III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK për programet:
 - 2.1. “Teknologji e Informimit dhe Komunikimit (TIK) me elektronikë, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (E) me 180 kredi të AAP”;
 - 2.2. “Teknik i Laboratorit Mjekësor, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”.
2. Veprimtaria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi ushtrohet në përputhje me certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe legjislacioni në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të lartcekura, Komisioni i veçantë i MASHTI-it, shqyrtoi kërkesën për rilicencim dhe licencim me nr. prot.3/1082 të datës 24.03.2025.

Komisioni në përputhje me legjislacionin në fuqi administroi dokumentacionin e ofruar, zhvilloi procedurat administrative, vizitoi institucionin dhe në bazë të Raportit, komisioni konstatoi se, IAP "Keka-Med" në Klinë, i ka plotësuar kushtet dhe kriteret bazë për zhvillimin dhe ofrimin e veprimtarisë për aftësim profesional, të përcaktuara me Udhëzimin administrativ nr. 17/2016, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. IAP "Keka-Med" në Klinë;
2. Kabinetit të Ministrit;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI;
4. Divizionit për arsimin privat parauniversitar;
5. Inspektoratit të arsimit në MASHTI;
6. Arkivit të MASHTI.

Valbona Feti-Mjeku, *kryesuese e komisionit*

